

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal,** Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Mihrie Krasniqi- Sheholli dhe bashkëpunëtoren profesionale Valbonë Fejza, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.P. me vendbanim në P., rr:”...” pnr., për shkak të veprës penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.495/18 të dt.01.03.2018 pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më dt.13.12.2018 në praninë e Prokurores së Shtetit – Ajshe Ferati, të dëmtuarve I.S. dhe M.H. dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë në prezencë të palëve mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 18.12.2018 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari,

**A.P.** nga i ati Rr. dhe nëna F., mbiemri i vajzërisë së nënës K., i lindur më datë *data e lindjes...*, me vendbanim në P., rr:”...” pnr., me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë-veteran, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike-financiare, sipas evidencës penale të kësaj gjykate i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar –Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

#### S e p s e :

Me dt.10.01.2018, rreth orës 18:20 në rrugën P.-P., në fshatin Ll., i pandehuri derisa ishte duke drejtuar automjetin e tipit “VW Golf”, me targa *targat e regjistrimit...*, nga pakujdesia ndërmer veprim të tejkalimit në vijë të plotë, duke mos u bindur paraprakisht se me një veprim të tillë do t’i pengoj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion në kundërshtim me nenin 72 par.1.9 të LRTR-së, ashtu që gjatë tejkalimit me pjesën e pasme të anës së djathtë të automjetit të tij, e godet automjetin “B”, të tipit “Mercedes-Mini Bus”, me targa *targat e regjistrimit...*, të cilin e drejtonte I.S., në pjesën anësore të anës së majtë ku pastaj humb kontrollin mbi automjet, del në shiritin e kahjes së kundërt ku goditet me automjetin “C”, të tipit “VW Golf”, me targa *targat...*, të cilin e drejtonte M.H. i cili po lëvizte nga drejtimi i kundërt, me ç’rast shkaktohet aksidenti i komunikacionit ku lëndime të lehta trupore pësojnë drejtuesi i automjetit “C”, i dëmtuari M.H. dhe pasagjerët në këtë automjet: S.H., E.H. dhe G.H.

-Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73, 74 dhe 378 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 366, 369, 370, 450, 453 dhe 463 të KPPRK-së, e:

## G J Y K O N

Të akuzuarin A.P. me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1(një) viti nuk kryen veprën të re penale, nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për ekspertizën e komunikacionit të paguaj shumën prej 40.88 Euro, për ekspertizën mjeko-ligjore, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30.00 Euro (tridhjetë/Euro) ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimin shumën prej 30.00€ (tridhjetë/Euro), të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Të dëmtuarit I.S. dhe M.H. kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore-juridike ndërsa të dëmtuarit tjerë S.H., E.H. dhe G.H. që të gjitha me vendbanim në fshatin Ll., Komuna e P. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën, PP.II.nr.495/18 të dt.01.03.2018 kundër të akuzuarit A.P. me vendbanim në P., rr:”...” pnr., për shkak të veprës penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 13.12.2018, në të cilën prezantuan prokurorja e shtetit Hava Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, të dëmtuarit I.S.i dhe M.H. si dhe i akuzuari.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale, i kërkoj falje të dëmtuarve, kërkoj nga gjykata një dënim sa më të butë, i premtoj gjykatës se do të jem më i kujdesshëm.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se ti akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimit të fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimit të fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

I dëmtuari I.S. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë, kërkesë pasurore-juridike nuk parashtroj ngase jam kompensuar.

I dëmtuari M.H. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë dhe nuk parashtroj kërkesë pasurore-juridike.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, të dëmtuarve I.S. dhe M.H. si dhe provave që gjenden në shkrësat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit A.P. përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Rrezikim i

Trafikut Publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 dhe 74 dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, për herë të parë ka ra në kundërshtim me ligjin, ndërsa si rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal  
P.nr.206/2018 me dt.18.12.2018**

**Zyrtare Ligjore  
Mihrie Krasniqi-Sheholli**

**Gjyqtari i vetëm gjykues  
Gazmend Bahtiri**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.